



VENDIMI I GJASHTË MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT PËR SHQYRTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Data e miratimit: 2 qershor 2026

Lënda nr. 2011-20

X dhe 115 ankues të tjerë

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (në vijim: Paneli), i mbledhur më 2 qershor 2026, në përbërje të anëtarëve të mëposhtëm:

Znj. Marina MANCINI, ushtruese e detyrës së kryesueses së Panelit
Z. Petko PETKOV, anëtar

i asistuar nga
Znj. Pia HOLM, zyrtare ligjore

pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, të parashtuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP, të datës 4 shkurt 2008, Konceptin e Llogaridhënies të EULEX-it, të datës 29 tetor 2009, për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregulloren e Punës së Panelit, të ndryshuar për herë të fundit më 2 qershor 2026,

pas shqyrtimit, vendos si në vijim:

I. HISTORIKU I PËRGJITHSHËM I LËNDËS DHE VENDIMI I PANELIT I DATËS 22 PRILL 2015

1. Kjo lëndë ka të bëjë me shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Koncretisht, ajo lidhet me keqtrajtimin dhe ekspozimin e zgjatur ndaj plumbit në kampin për persona të zhvendosur brenda vendit (PZhBV), si dhe me cenimin e të drejtave themelore të 115 ankuesve të përkatësisë etnike rome, si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve që u atribuohen autoriteteve të ndryshme.
2. Për shkak të kufizimeve të juridiksionit të tij, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ishte kompetent vetëm për të shqyrtuar shkeljet e të drejtave të njeriut që i atribuoheshin Misionit të EULEX-it në Kosovë (në vijim: Misioni), gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.

3. Me vendimin e datës 22 prill 2015, Paneli konstatoi se Misioni ishte përgjegjës për shkeljen e të drejtës së këtyre personave për mjet juridik efektiv, siç garantohet, ndër të tjera, nga neni 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Veçanërisht i rëndësishëm për konstatimet e Panelit ishte dështimi i Misionit për të zhvilluar një hetim efektiv lidhur me rrethanat në të cilat të drejtat themelore të viktimave ishin cenuar nga autoritete të tjera.
4. Në përputhje me këtë, Paneli i drejtoi Shefit të Misionit (në vijim: ShM) rekomandimet e mëposhtme, në bazë të Rregullës 34 të Rregullores së Punës:

“Shefi i Misionit duhet t’i udhëzojë zyrtarët kompetentë të EULEX-it që të kërkojnë informacion nga autoritetet e Kosovës nëse është duke u zhvilluar një hetim lidhur me këtë çështje dhe, nëse po, në cilën fazë të procedurës ndodhet ai. Shefi i Misionit duhet ta informojë Panelin për rezultatin e kësaj kërkesë.

Pas marrjes së këtij informacioni, ShM-ja duhet t’i udhëzojë prokurorët e EULEX-it që të shqyrtojnë nëse duhet të marrin përsipër përgjegjësinë për këtë rast në përputhje me nenin 7A të Ligjit nr. 04/L-273, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse të përmendura më sipër, veçanërisht nevojën që Misioni të garantojë mbrojtjen efektive të të drejtave të parashtruesve të ankesës. Shefi i Misionit duhet ta informojë Panelin për vendimin e prokurorit lidhur me këtë çështje.”

5. Paneli gjithashtu kërkoi që Shefi i Misionit i asaj kohe t’ia ofronte Panelit informacionin e kërkuar jo më vonë se më 15 qershor 2015.
6. Më 31 gusht 2015, Shefi i Misionit e informoi Panelin për një sërë masash të ndërmarra në lidhje me rekomandimet e Panelit. Në veçanti, ai i drejtoi një shkresë Ushtruesit të Detyrës së Shefit të Divizionit Ekzekutiv të EULEX-it dhe Kryeprokurorit në Detyrë të EULEX-it, duke u kërkuar atyre që të shqyrtonin vendimin e Panelit dhe të vlerësonin nëse neni 7A i Ligjit nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës (Ligji për Juridiksionin) mund të zbatohet në rastin penal në fjalë, si dhe të shqyrtonin mundësinë e caktimit të një prokurori të EULEX-it për këtë rast për shkak të “rrethanave të jashtëzakonshme”, në kuptim të kësaj dispozite.
7. Më 19 gusht 2015, ata e informuan Shefin e Misionit se, siç kërkohet nga neni 7A i Ligjit për Juridiksionin, Kryeprokurori i Shtetit i Kosovës dhe Kryeprokurori i EULEX-it e kishin vlerësuar bashkërisht lëndën dhe kishin arritur në përfundimin se “rrethanat e jashtëzakonshme”, të kërkuara nga neni 7A, nuk ishin përmbushur dhe se juridiksioni i prokurorëve të EULEX-it nuk mund të aktivizohej. Megjithatë, Kryeprokurori në Detyrë i EULEX-it e siguroi Shefin e Misionit se, nëse rrethana të tilla do të paraqiteshin në të ardhmen, lënda dhe zbatueshmëria e nenit 7A mund të rishqyrtoheshin.
8. Më tej, Kryeprokurori në Detyrë i EULEX-it parashtroi se, në vendimin e tij për themelin e rastit në fjalë, Paneli e kishte kritikuar EULEX-in për fillimin e hetimit një ditë pas të ashtuquajturës “datë e fatit përfundimtar”, më 14 prill 2014. Ai theksoi, megjithatë, se lënda mbetej në fazën paraprake hetimore me qëllim të përcaktimit nëse ishte kryer një vepër penale dhe, nëse po, kush mund të ishte i

dysuari për kryerjen e saj. Kryeprokurori në Detyrë i EULEX-it gjithashtu parashtroi se përfaqësuesi i ankuesve nuk u ishte përgjigjur kërkesave për informacion të dërguara nga prokurori vendor dhe se informacioni i ofruar nga ankuesit dukej se kishte vlerë shumë të kufizuar provuese.

9. Pavarësisht sa më sipër, prokurori vendor i caktuar për rastin në fjalë ia përcolli kallëzimin penal Prokurorisë Speciale të Kosovës për të vlerësuar nëse ai binte në kompetencën e saj. Përgjigjja ishte negative. Sipas Zëvendëskryeprokurorit të Prokurorisë Speciale, nuk kishte indikacione për përfshirjen e krimit të organizuar në këtë rast dhe, rrjedhimisht, nuk hynte në juridiksionin e saj. Për pasojë, rasti mbeti në trajtim nga autoritetet prokuroriale të Kosovës.
10. Kryeprokurori në Detyrë i EULEX-it dha garanci se prokurori i EULEX-it, i cili më parë kishte qenë i caktuar në këtë rast, do të vazhdonte të ishte në dispozicion të prokurorit vendor në kuadër të rolit të tij këshillues dhe monitorues.
11. Më 13 shtator 2015, ankuesit parashtuan përgjigjen e tyre lidhur me informacionin e dhënë nga Shefi i Misionit. Ata nuk u pajtuan me qëndrimin e Shefit të Misionit se rasti ishte jashtë juridiksionit të EULEX-it. Gjithashtu, ata pohuan se, në kundërshtim me pretendimet e Shefit të Misionit, përfaqësuesi i tyre nuk ishte kontaktuar nga EULEX-i.
12. Në vijim, Paneli ka nxjerrë pesë (5) vendime pasuese lidhur me këtë rast.

II. VENDIMI I PARË PASUES

13. Në vendimin pasues të datës 11 nëntor 2015, Paneli mori parasysh hapat e ndërmarrë nga Shefi i Misionit për zbatimin e rekomandimeve të Panelit, siç ishin paraqitur në shkresën e tij të datës 31 gusht 2015.
14. Paneli u bind se Shefi i Misionit kishte zbatuar rekomandimin e tij për të kërkuar informacion nga autoritetet vendore nëse hetimi ishte ende në zhvillim. Në këtë kontekst, Paneli vuri në dukje se rasti ishte sjellë për herë të parë në vëmendjen e autoriteteve prokuroriale të Kosovës në nëntor 2013, pothuajse dy vjet më parë. Gjithashtu, Paneli vuri në dukje se Shefi i Misionit nuk kishte ofruar asnjë informacion nëse gjatë hetimit ishte administruar ndonjë provë ose nëse autoritetet prokuroriale të Kosovës kishin marrë në pyetje ndonjë dëshmitar. Shefi i Misionit gjithashtu nuk kishte ofruar informacion lidhur me afatin e mundshëm kohor brenda të cilit rasti mund të përfundonte. Po ashtu, nuk ishte vërtetuar se viktimat ishin përfshirë në mënyrë kuptimplotë në hetimin që vazhdonte të ishte në zhvillim. Për rrjedhojë, Paneli nuk u bind se hetimi kishte shënuar përparim real. Në këto rrethana, e drejta e ankuesve për mjet juridik efektiv, sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vazhdonte të konsiderohej e cenuar për shkak të mungesës së një përpjekjeje të dëshmuar për zhvillimin e një hetimi të menjëhershëm dhe efektiv të lëndës.
15. Për më tepër, Paneli vuri në dukje se Kryeprokurori i Shtetit i Kosovës dhe Kryeprokurori i EULEX-it kishin vendosur të mos ia caktonin lëndën një prokurori të EULEX-it. Paneli konsideroi se efektiviteti i hetimit do të ishte përmirësuar ndjeshëm sikur të ishin vënë në dispozicion ekspertiza dhe burimet e EULEX-it.

16. Rrjedhimisht, Paneli konsideroi se hapat e ndërmarrë nga EULEX-i deri në atë kohë nuk ishin të mjaftueshëm për të garantuar mbrojtjen efektive të së drejtës themelore të ankuesve për mjet juridik efektiv. Prandaj, ai e ftoi Misionin të vazhdonte bashkëpunimin me autoritetet kompetente të Kosovës me qëllim të ndjekjes së ecures së hetimit. Paneli gjithashtu e ftoi Shefin e Misionit të ofronte informacion lidhur me mënyrën se si interpretohet në praktikë nocioni i “rrethanave të jashtëzakonshme”, në kuptim të nenit 7A, si kriter për vendosjen nëse një rast duhet të merret në kompetencë nga autoritetet prokuroriale të EULEX-it.
17. Paneli deklaroi se Shefi i Misionit i kishte zbatuar rekomandimet e tij *vetëm pjesërisht* dhe se e drejta e ankuesve për mjet juridik efektiv vazhdonte të cenohej për shkak të mungesës së një hetimi efektiv të dëshmuar lidhur me lëndën në fjalë. Shefi i Misionit u ftua ta përditësonte Panelin mbi ecurinë e hetimit jo më vonë se më 28 shkurt 2016.
18. Shefi i Misionit iu përgjigj Panelit më 2 mars 2016. Lidhur me interpretimin e nocionit “rrethana të jashtëzakonshme”, në kuptim të nenit 7A, si kriter për vendosjen nëse një rast duhet të merret në kompetencë nga autoritetet prokuroriale të EULEX-it, Shefi i Misionit u përgjigj se zbatimi i nenit 7A kërkonte një vendim të përbashkët të Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës dhe Kryeprokurorit të EULEX-it; rrjedhimisht, secila lëndë vlerësohej në mënyrë të përbashkët.
20. Shefi i Misionit theksoi se procedura për vlerësimin e ekzistencës së rrethanave të tilla ishte dakorduar ndërmjet Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës dhe Kryeprokurorit në Detyrë të EULEX-it në tetor 2014. Konkretisht, në çdo vlerësim të tillë do të zbatoheshin kriteret e mëposhtme:
 - nëse ekspertiza dhe përvoja e prokurorëve të EULEX-it do të garantonin zhvillimin e duhur të hetimit dhe ndjekjes penale të lëndës;
 - nëse ekzistonte dyshim i bazuar për përpjekje për të ndikuar në hetimin ose ndjekjen penale;
 - nëse lënda që është objekt hetimi ose ndjekjeje penale prek interesat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian ose përfshin ndonjë anëtar të stafit të EULEX-it në Kosovë.
21. Shefi i Misionit deklaroi se, nëse një ose më shumë nga këto kritere përmbushen, Kryeprokurori dhe Zëvendëskryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Kosovës, ose Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, së bashku me prokurorin e EULEX-it, do t'i paraqisnin një propozim të arsyetuar Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës dhe Kryeprokurorit të EULEX-it, me qëllim që lënda t'i caktohej një prokurori të EULEX-it, qoftë në mënyrë ekskluzive, qoftë në mënyrë të përbashkët në kuadër të një ekipi të përzier, varësisht nga rrethanat e lëndës.
22. Meqenëse prokurorët e EULEX-it kishin qenë të përfshirë në lëndën në fjalë që në fazat e hershme të saj, u konsiderua se asnjëri nga kriteret e lartpërmendura nuk ishte përmbushur. Lënda nuk kishte asnjë karakteristikë që do të kërkonte ekspertizën e veçantë prokuroriale të prokurorëve të EULEX-it; nuk kishte

indikacione për ndonjë përpjekje për të ndikuar në hetim; ndërsa prokurorët vendorë kishin treguar gatishmëri dhe aftësi për ta trajtuar këtë lëndë. Për rrjedhojë, fillimisht ishte krijuar një ekip i përzier. Për më tepër, lënda nuk dukej se prekte interesat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe nuk përfshinte ndonjë anëtar të stafit të EULEX-it.

23. Shefi i Misionit po ashtu theksoi se lënda kishte qenë dhe vazhdonte të ishte në fazën paraprake të hetimit, me qëllim të përcaktimit nëse ishte kryer ndonjë vepër penale dhe, nëse po, për cilën vepër penale bëhej fjalë dhe kush mund të ishin të dyshuarit. Ai gjithashtu theksoi se përfaqësuesi i ankuesve nuk u ishte përgjigjur kërkesave të fundit për informacion të dërguara nga prokurori vendor dhe se informacioni i ofruar deri atëherë nga ankuesit dukej se kishte vlerë të kufizuar provuese.
24. Lidhur me statusin aktual të lëndës, Shefi i Misionit theksoi se prokurori i EULEX-it ishte takuar me prokurorin e ri vendor të caktuar për lëndën, pas pezullimit të prokurorit që fillimisht ishte ngarkuar me të për shkak të dyshimeve për keqpërdorim të detyrës zyrtare, me qëllim që të diskutonin hapat e ndërmarrë deri atëherë. Prokurori vendor kishte shprehur keqardhje që nuk kishte qenë në gjendje të ndërmerre veprime hetimore, duke pretenduar se ishte i mbingarkuar me hetimin e lëndëve më urgjente, në të cilat të pandehurit ndodheshin në paraburgim. Megjithatë, ai e kishte informuar prokurorin e EULEX-it për synimin e tij që të konsultohet me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit për të marrë udhëzime lidhur me lëndën dhe kishte deklaruar se do të vepronte më tej në përputhje me rezultatin e atij konsultimi.
25. Prokurori vendor kishte theksuar gjithashtu se vepra penale që me gjasë mund të rezultonte nga kjo lëndë ishte ajo e "Shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm", e dënueshme sipas nenit 365 të Kodit Penal të Kosovës (Ligji nr. 04/L-082). Në ato rrethana, do të zbatohet afati i parashkrimit i përcaktuar në nenin 106 të Kodit Penal të Kosovës dhe, për rrjedhojë, ekzistonte një mundësi e konsiderueshme që ndjekja penale për këtë vepër tashmë të ishte parashkruar. Në praktikë, kjo nënkuptonte se kallëzimi penal do të duhej të hidhej poshtë.
26. Shefi i Misionit deklaroi se Kryeprokurori i EULEX-it kishte siguruar se prokurori i EULEX-it i caktuar më parë në këtë lëndë mund t'i vihej në dispozicion prokurorit vendor në cilësinë e mentorit dhe këshilltarit, jashtë funksionit ekzekutiv të EULEX Kosovë. Përveç kësaj, çdo palë mund t'i paraqiste në çdo kohë parashtrësë të arsyetuar Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës dhe Kryeprokurorit të EULEX-it, nëse konsideronte se rrethanat kishin ndryshuar në mënyrë të tillë që kushtet e përcaktuara në nenin 7A të Ligjit për Juridiksionin të konsideroheshin të përmbushura. Shefi i Misionit theksoi gjithashtu se Kryeprokurori i EULEX-it ia kishte përcjellë Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës vendimin e Panelit dhe analizën e tij lidhur me lëndën për shqyrtim.
27. Më 12 korrik 2016, Sekretariati i Panelit i shkroi Shefit të Misionit për ta njoftuar se Paneli ishte në prag të shqyrtimit të mëtejshëm të lëndës me qëllim të nxjerrjes së vendimit të dytë pasues. Në këtë drejtim, Paneli kërkoi të dinte nëse Shefi i Misionit kishte në dispozicion ndonjë informacion shtesë, veçanërisht nëse kishte pasur ndonjë përparim në procedurat hetimore. Paneli gjithashtu e pyeti Shefin e Misionit nëse prokurori i EULEX-it kishte qenë i përfshirë në cilësinë e mentorit

dhe monitoruesit. Paneli kërkoi që Shefi i Misionit t'i përgjigjej deri më 19 gusht 2016.

28. Shefi i Misionit u përgjigj më 17 gusht 2016, duke bërë të ditur se lënda tashmë hynte në kompetencën ekskluzive të prokurorit vendor në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë dhe se prokurorët e EULEX-it, në fakt, nuk ishin të përfshirë në asnjë aktivitet formal mentorimi ose monitorimi. Megjithatë, Shefi i Misionit deklaroi se udhëheqësi i ekipit të prokurorëve të EULEX-it në Mitrovicë ishte takuar me prokurorin vendor të sapocaktuar më 2 shkurt 2016 (shih paragrafin 23 më sipër) dhe përsëri më 3 gusht 2016, për të verifikuar nëse kishte pasur ndonjë përparim të mëtijshëm në hetim.
29. Në takimin e 3 gushtit 2016, prokurori vendor deklaroi se nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim hetimor që nga takimi i 2 shkurtit 2016. Megjithatë, ai tregoi se e kishte shqyrtuar lëndën dhe kishte arritur në përfundimin se ajo mund të zhvillohej në dy drejtime të mundshme. Së pari, lënda mund të ndiqej penalisht nën akuzën për "shkaktim të rrezikut të përgjithshëm"; dhe së dyti, nën akuzën për "krim të organizuar", çka do të nënkuptonte se lënda do të hynte në kompetencën ekskluzive të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Ai dukej se favorizonte opsionin e parë, i cili do të çonte në mbylljen e lëndës për shkak të afatit ligjor të parashkrimit të përcaktuar në nenin 106 të Kodit Penal të Kosovës.
30. Prokurori i EULEX-it kishte caktuar një takim pasues me prokurorin vendor për datën 10 gusht 2016, por ky takim u anulua më vonë nga ky i fundit me arsyetimin se kishte detyra më urgjente për të kryer.
31. Në përfundim, Shefi i Misionit deklaroi se, për shkak të mungesës së progresit në lëndë dhe mungesës së angazhimit real nga ana e prokurorit vendor, Kryeprokurori i EULEX-it kishte kërkuar më 10 gusht 2016 që Njësia Këshillimore e EULEX-it për Çështjet e Drejtësisë ta monitoronte lëndën në mënyrë formale.

III. VENDIMI I DYTË PASUES

31. Në vendimin e dytë pasues të datës 10 janar 2017, Paneli mori parasysh hapat e mëtijshëm të ndërmarrë nga Shefi i Misionit për zbatimin e rekomandimeve të tij. Megjithatë, ai konsideroi se këta hapa nuk ishin të mjaftueshëm "për të siguruar që e drejta e parashtruesve të ankuesës për mjet juridik efektiv po mbrohet në mënyrë efektive". Pas shqyrtimit të informacionit më të fundit të ofruar nga Shefi i Misionit, Paneli nxori konstatimet dhe rekomandimet e mëposhtme:

"Deklaron se Shefi i Misionit deri në atë kohë nuk kishte arritur t'i zbatonte më tej rekomandimet e dhëna nga Paneli, siç përcaktohen në Vendimin dhe Konstatimet fillestare të Panelit të datës 22 prill 2015;

Deklaron se e drejta e parashtruesve të ankesës për mjet juridik efektiv vazhdon të cenohet për shkak të mungesës së një hetimi efektiv të dëshmueshëm në këtë lëndë;

Fton Misionin, nëpërmjet Shefit të Misionit, të kërkojë përditësime të rregullta nga autoritetet e Kosovës lidhur me ecurinë e hetimit, veçanërisht lidhur me statusin e monitorimit formal të lëndës nga prokurori i EULEX-it;

Fton Misionin të vazhdojë bashkëpunimin me autoritetet kompetente të Kosovës me qëllim të përcjelljes së ecurisë së kësaj lënde;

Fton Shefin e Misionit ta informojë Panelin lidhur me ecurinë e hetimit në fjalë deri më 28 shkurt 2017.”

32. Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e datës 29 maj 2017, Shefi i Misionit e informoi Panelin se, në kundërshtim me njoftimet e mëparshme, lënda nuk ishte mbyllur, por vazhdonte të hetohej nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë (Vushtri).
33. Më 15 dhjetor 2017, Paneli i shkroi sërish Shefit të Misionit për të kërkuar informacion lidhur me zhvillimet e reja në këtë lëndë.
34. Shefi i Misionit u përgjigj me shkresën e datës 30 mars 2018, duke bërë të ditur se Misioni kishte zhvilluar disa takime me autoritetet përkatëse policore dhe prokuroriale “për të kërkuar përditësime lidhur me ecurinë e hetimit”. Shefi i Misionit gjithashtu sqaroi se hetimi i lëndës ishte monitoruar nga Njësia Këshillimore për Çështjet e Drejtësisë në kuadër të Divizionit për Përforsim që nga gushti 2016. Ai saktësoi se lënda mbetej aktive, por ende ndodhej në fazën paraprake të hetimit dhe vazhdonte të monitorohej nga Njësia Këshillimore për Çështjet e Drejtësisë.
35. Me shkresën e datës 12 prill 2018, Paneli konfirmoi pranimin e shkresës së fundit të Shefit të Misionit dhe e ftoi atë ta plotësonte përgjigjen e tij me informacion lidhur me çdo përparim të mëtejshëm të arritur në këtë lëndë.
36. Shefi i Misionit u përgjigj me shkresën e datës 22 maj 2018, në të cilën bëri të ditur se “nuk ka pasur ndonjë përparim të mëtejshëm thelbësor që nga shkresa e datës 30 mars 2018”. Ndonëse iu referua një numri takimesh të zhvilluara lidhur me këtë lëndë, Shefi i Misionit deklaroi se situata “nuk kishte ndryshuar” që nga përditësimi i fundit dhe se ende nuk ishte marrë ndonjë vendim për fillimin e hetimit. Shefi i Misionit gjithashtu theksoi qëndrimin e tij se “është përgjegjësi e institucioneve të Kosovës të zhvillojnë një hetim efektiv”. Së fundi, Shefi i Misionit u zotua se do të vazhdonte të monitoronte zhvillimet në këtë lëndë brenda mundësive dhe kapaciteteve të Misionit.
37. Me shkresën e datës 17 janar 2019, Paneli dërgoi një kërkesë tjetër për informacion të përditësuar lidhur me lëndën. Në veçanti, Shefi i Misionit u ftua të jepte sqarime lidhur me sa vijon:
 - nëse Misioni kishte dijeni për ndonjë zhvillim në këtë lëndë që nga përditësimi i fundit;
 - nëse Misioni kishte ndërmarrë ndonjë hap ose masë shtesë për zbatimin e rekomandimeve të Panelit që nga ajo kohë;

- nëse, sipas njohurive të Misionit, autoritetet vendore kishin ndërmarrë ndonjë veprim për ta çuar përpara hetimin e kësaj lëndë dhe, në veçanti, nëse lënda ishte ende aktive apo ishte mbyllur;
 - nëse vendimet e Panelit lidhur me këtë lëndë u ishin komunikuar autoriteteve vendore së bashku me dosjen e lëndës;
 - nëse Misioni po zhvillonte ose planifikonte të zhvillonte ndonjë veprim pasues, qoftë në formën e monitorimit apo në ndonjë formë tjetër, lidhur me këtë lëndë.
38. Më 20 shkurt 2019, Shefi i Misionit iu përgjigj kërkesave të Panelit. Shefi i Misionit bëri të ditur se Njësia për Monitorimin e Rasteve kishte kontaktuar prokurorin kompetent në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë dhe ishte informuar se lënda ndodhej ende në fazën paraprake të hetimit. Gjithashtu, Shefi i Misionit vuri në dukje ndryshimin e natyrës së mandatit të Misionit dhe deklaroi se Misioni do të vazhdonte ta monitoronte lëndën në mënyrë periodike. Shefi i Misionit theksoi se, sipas mandatit aktual, Misioni nuk ishte i autorizuar t'u ofronte këshilla institucioneve vendore lidhur me lëndë individuale dhe nuk ishte në pozitë të garantonte që viktimat të gëzonin të drejtën për mjet juridik efektiv. Gjithashtu, u bë e ditur se Kryeprokurori i Shtetit i Kosovës ishte informuar për vendimin e Panelit, si dhe për vendimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNj) lidhur me këtë lëndë.
39. Më 22 shkurt 2019, shkresa e Shefit të Misionit iu përcoll përfaqësueses së ankuesve për informim, me qëllim që ankuesve t'u jepej mundësia të paraqisnin vërejtjet e tyre lidhur me të. Po atë ditë, përfaqësuesja e ankuesve konfirmoi pranimin e shkresës si dhe konfirmoi se vazhdonte të ishte përfaqësuese e viktimave dhe njoftoi se çdo parashtresë shtesë do ta paraqiste jo më vonë se më 15 mars 2019.
40. Më 3 mars 2019, përfaqësuesja e ankuesve i shkroi Panelit dhe iu përgjigj parashtresave të Shefit të Misionit. Ajo deklaroi se përgjigjja e Shefit të Misionit "nuk përmbante asgjë të re" dhe se konsistonte në sugjerimin se: (a) Misioni nuk është përgjegjës; dhe (b) refuzon t'i pranojë ose t'i zbatojë vendimet e Panelit. Ajo gjithashtu vuri në pikëpyetje vërtetësinë dhe besueshmërinë e pretendimit se lënda po hetohej nga autoritetet e Kosovës. Për më tepër, ajo e ftoi Panelin të shqyrtonte mundësinë e urdhërimit të kompensimit për secilën familje.

IV. VENDIMI I TRETË PASUES

41. Më 27 mars 2019, Paneli nxori vendimin e tij të tretë pasues. Në atë vendim, ai konstatoi se ankuesve ende nuk u ishte siguruar një mjet juridik efektiv dhe dëmshpërblim për shkeljen e të drejtave të tyre.
42. Paneli vuri në dukje gjithashtu se autoritetet vendore po e trajtonin lëndën në mënyrë të vazhdueshme dhe po zhvillonin hetime lidhur me të, si dhe angazhimin e Misionit për të monitoruar rregullisht veprimet e tyre në lidhje me hetimin. Paneli theksoi nevojën që Misioni t'ua bënte të qartë autoriteteve vendore se kjo lëndë

duhej të hetohej plotësisht dhe në mënyrë efektive, pasi kishte të bënte me shkelje shumë të rënda të të drejtave të njeriut.

43. Së fundi, në përgjigje të parashtresave të përfaqësueses së ankuesve, Paneli vuri në dukje se nuk kishte kompetencë, sipas instrumentit të tij themelues, të urdhëronte pagesën e kompensimit financiar për një ankues (Raporti Vjetor i PShDNj-së për vitin 2016, fq. 2 dhe 48–50; *Zahiti kundër EULEX-it*, lënda nr. 2012-14, 11 nëntor 2014, në veçanti paragrafi 16).
44. Më 12 shtator 2019, Paneli iu drejtua sërish Shefit të Misionit për të kërkuar informacion shtesë lidhur me zbatimin e rekomandimeve të tij dhe përpjekjet për të korrigjuar shkeljet e konstatuara në këtë lëndë.
45. Më 31 tetor 2019, Misioni iu përgjigj Panelit dhe ofroi informacion lidhur me verifikimet e kryera prej tij. Një pjesë e këtij informacioni iu vu në dispozicion Panelit në mënyrë konfidenciale. Megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij informacioni, Paneli e ftoi Misionin të shqyrtonte mundësinë e ndarjes së tij me autoritetet përkatëse të Bashkimit Evropian, me qëllim të adresimit të çështjeve të ngritura në të.
46. Lidhur me pyetjen e Panelit nëse Misioni kishte dijeni për ndonjë zhvillim në hetimin e lëndës, Misioni bëri të ditur se lënda mbetej aktive:

“Por, për fat të keq, nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret që nga shkresa e EULEX-it e datës 20 shkurt 2019 drejtuar Panelit. Nuk është nxjerrë asnjë aktvendim për fillimin e hetimit.”
47. Në përgjigje të pyetjes së Panelit lidhur me hapat ose masat e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të tij që nga 20 shkurti 2019, Misioni bëri të ditur se i kishte dorëzuar prokurorit përgjegjës për lëndën një kopje të “Vendimit të Tretë Pasues mbi Zbatimin e Rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut”, të datës 27 mars 2019, si dhe vendime të tjera të PShDNj-së që lidhen me këtë lëndë. Misioni shtoi se kishte kërkuar gjithashtu informacion nga prokurori lidhur me ndonjë zhvillim të mundshëm të lëndës që nga shkurti 2019 dhe ishte informuar se nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim i mëtejshëm.

V. VENDIMI I KATËRT PASUES

48. Më 11 dhjetor 2019, Paneli nxori vendimin e tij të katërt pasues. Në atë vendim, Paneli vuri në dukje se ankuesve ende nuk u ishte siguruar një mjet juridik efektiv dhe dëmshpërblim për shkeljen e të drejtave të tyre dhe nxori rekomandimet e mëposhtme:

Fton Misionin të vazhdojë ushtrimin e mandatit të tij në masën më të plotë të mundshme, me qëllim që të sigurojë që të drejtat e ankuesve të respektohen dhe garantohen plotësisht, si dhe t’u përcjellë autoriteteve kompetente vendore një kopje të këtij vendimi;

Fton Misionin të shqyrtojë mundësinë e ndarjes së përmbajtjes së informacionit konfidencial me autoritetet përkatëse të Bashkimit Evropian;

Fton Misionin të ndajë një kopje të këtij vendimi me organet përkatëse brenda Misionit dhe me bashkëbiseduesit përkatës jashtë tij;

Fton Misionin të kryejë një rishikim të plotë të mjeteve që ka në dispozicion për të korrigjuar në mënyrë efektive shkeljen e të drejtave të ankuesve dhe ta informojë Panelin për masat që propozon të ndërmarrë për këtë qëllim;

Fton Misionin që, sipas rastit, t'i informojë dhe t'i përfshijë ankuesit në kryerjen e këtij rishikimi;

Fton Misionin të shqyrtojë mundësinë që, përmes Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm, t'u drejtohet shteteve anëtare lidhur me mundësinë e dëmshpërblimit ose kompensimit për shkeljen e të drejtave të ankuesve, e cila i është atribuar Misionit nga Paneli."

49. Me datë 18 dhjetor 2019, Paneli ia komunikoi vendimin e tij Shefit të Misionit dhe i kërkoi Misionit të paraqiste përgjigje lidhur me kërkesat e lartpërmendura deri më 16 mars 2020.
50. Paneli, më 20 gusht 2021, i shkroi sërish Misionit, duke kërkuar informacion lidhur me zbatimin e rekomandimeve të përfshira në vendimin e katërt pasues, sa më parë që të ishte e mundur.
51. Shefi i Misionit u përgjigj me shkresën e datës 20 dhjetor 2021, duke e informuar Panelin se, pas vendimit të fundit, Misioni kishte bërë kërkesa të mëtejshme për informacion pranë autoriteteve përkatëse prokuroriale dhe se nuk kishte pasur asnjë përparim në hetim, i cili vazhdonte të mbetej i hapur. Për më tepër, Shefi i Misionit kërkoi që Paneli ta mbyllte shqyrtimin e lëndës.
52. Më 22 dhjetor 2021, shkresa e ShM-së iu përcoll përfaqësueses së ankuesve për informim, me qëllim që ankuesve t'u jepej mundësia të paraqisnin vërejtjet e tyre lidhur me të.
53. Të nesërmen, përfaqësuesja e ankuesve u përgjigj duke deklaruar se mjeti juridik efektiv ende nuk ishte siguruar. Ajo sugjeroi se Misioni mund të kishte kontaktuar Ministrin e Drejtësisë dhe Ministrin për Komunitete dhe Kthim lidhur me këtë lëndë. Ajo sugjeroi gjithashtu që Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin, i krijuar së fundmi, mund të ishte informuar për këtë çështje. Sipas saj, në vend të kësaj, Misioni në thelb nuk ishte përgjigjur pothuajse në asnjërën prej kërkesave të Panelit.
54. Me shkresën e datës 18 janar 2022, Paneli i përcolli Shefit të Misionit një kopje të letrës së parashtruesve të ankesës. Shefi i Misionit nuk paraqiti parashtrësia të mëtejshme.

VI. VENDIMI I PESTË PASUES

55. Me datë 18 gusht 2022, Paneli nxori vendimin e tij të pestë pasues. Ai konstatoi se parashtruesve të ankesës ende nuk u ishte siguruar qasje në një mjet juridik

efektiv dhe në një formë adekuate dëmshpërblimi për shkeljen e të drejtave të tyre.

56. Paneli shprehu shqetësim jo vetëm për faktin se lënda ende nuk po hetohej nga autoritetet vendore, por edhe për faktin se Misioni nuk kishte marrë në konsideratë asnjërin nga rekomandimet e përcaktuara në vendimin e katërt pasues.
57. Paneli ritheksoi se detyrimi i Misionit për të korrigjuar dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrimeve të tij në fushën e të drejtave të njeriut, sipas së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, vazhdonte të ekzistonte dhe se Misioni nuk mund ta përdorte ndryshimin e mandatit të tij, pas konstatimit të shkeljes, si arsytim për të mos siguruar një mjet juridik efektiv. Paneli pranoi se hetimi tani ishte në kompetencë të autoriteteve vendore, veprimet e të cilave ai nuk kishte kompetencë t'i vlerësonte në aspektin e përputhshmërisë me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut. Megjithatë, ai theksoi se mosarritja e vazhdueshme për të siguruar një formë hetimi dhe një mjet juridik efektiv për parashtruesit e ankesës do të nënkuptonte domosdoshmërisht vazhdimin e shkeljes së të drejtave të tyre nga Misioni.
58. Paneli shprehu gjithashtu shqetësim të thellë për faktin se Shefi i Misionit kishte shpërfillur plotësisht ftesën e Panelit drejtuar Misionit për të kryer një rishikim të plotë të mjeteve në dispozicion për korrigjimin e shkeljes, për të ndarë përmbajtjen thelbësore të informacionit konfidencial me autoritetet përkatëse të Bashkimit Evropian dhe për t'iu drejtuar Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS) me qëllim shqyrtimin e mundësisë së ofrimit të një forme dëmshpërblimi.
59. Në dritën e sa më sipër, Paneli vendosi ta mbante lëndën të hapur, ritheksoi në tërësi rekomandimet e përcaktuara në vendimin e katërt pasues dhe e ftoi Misionin të paraqiste një përditësim lidhur me zbatimin e tyre deri më 15 nëntor 2022.

VII. VENDIMI PASUES

60. Më 4 nëntor 2022, Misioni propozoi të bënte një paraqitje gojore në vend të parashtrësave me shkrim. Megjithatë, paraqitja gojore nuk u mbajt për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm të Panelit.
61. Më 14 gusht 2023, Paneli i shkroi Misionit, duke ritheksuar ftesën për të paraqitur një përditësim lidhur me zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara në vendimin e katërt pasues dhe të ritheksuara në tërësinë e tyre në vendimin e pestë pasues, deri më 2 tetor 2023.
62. Shefi i Misionit u përgjigj me një shkresë të datës 14 nëntor 2023. Ai deklaroi se më 7 shkurt 2023, paraardhësi i tij kishte vizituar Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për të marrë informacion të përditësuar lidhur me hetimin e lëndës dhe ishte informuar se lënda mbetej aktive, por se nuk kishte pasur asnjë përparim. ShM-ja theksoi:

“Prandaj, çështja mbetet në kompetencë të autoriteteve të Kosovës dhe nuk ka asgjë më tej që EULEX-i mund të bëjë, pasi ai as nuk mund të ndërhyjë në vendimet apo veprimet e pavarura prokuroriale, e as t’i ndërmarrë këto veprime në emër të autoriteteve të Kosovës.”

63. Lidhur me rekomandimin për të shqyrtuar mundësinë e ndarjes së përmbajtjes së informacionit konfidencial me autoritetet përkatëse të Bashkimit Evropian, ShM-ja bëri të ditur se një shkresë lidhur me atë informacion i ishte dërguar Komandantit të Operacioneve Civile.
64. Sa i përket rekomandimit për ndarjen e kopjeve të vendimit të katërt dhe të pestë pasues me organet përkatëse brenda Misionit dhe me bashkëbiseduesit përkatës jashtë tij, Shefi i Misionit deklaroi vetëm se të gjitha vendimet e Panelit u shpërndahen njësisë përkatëse brenda Misionit.
65. Lidhur me rekomandimin për kryerjen e një rishikimi të plotë të mjeteve në dispozicion të Misionit për korrigjimin e shkeljes së të drejtave të ankuesve dhe për përfshirjen e ankuesve në një rishikim të tillë, ShM-ja deklaroi:
- “Misioni nuk ka mjete për të korrigjuar shkeljen e identifikuar nga Paneli; ai e ka ushtruar mandatin e tij në masën më të plotë të mundshme gjatë një periudhe disavjeçare dhe nuk ka informacion shtesë që mund të ofrohet, as ndonjë arsye për të përfshirë ankuesit.”
66. Sa i përket rekomandimit për të shqyrtuar mundësinë e kontaktimit të shteteve anëtare, përmes Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS), lidhur me mundësinë e dëmshpërblimit ose kompensimit për shkeljen e të drejtave të ankuesve nga Misioni, ShM-ja deklaroi se Misioni nuk mund t’u drejtohej shteteve anëtare lidhur me këtë çështje.
67. Më 6 janar 2026, Paneli i shkroi sërish Misionit, duke pyetur nëse Misioni kishte ndërmarrë ndonjë hap të mëtijshëm për zbatimin e rekomandimeve të përfshira në vendimin e pestë pasues.
68. Shefi i Misionit u përgjigj me shkresën e datës 12 shkurt 2026. Ai deklaroi se:
- “Për të zbatuar rekomandimet e Panelit në këtë lëndë, në masën që kjo ka qenë e mundur, EULEX-i, për shumë vite me radhë, e ka ushtruar mandatin e tij me kujdes dhe në mënyrë të vazhdueshme, në masën më të plotë të mundshme... EULEX-i konsideron se nuk ka hapa të mëtijshëm që mund të ndërmarrë në lidhje me lëndën në fjalë.”
69. Paneli merr parasysh deklaratën e lartpërmendur dhe arrin në përfundimin se nuk mund të priten në mënyrë të arsyeshme përpjekje të mëtijshme nga Misioni për zbatimin e rekomandimeve të tij.

PËR KËTO ARSYE, PANELI

DEKLARON se Shefi i Misionit i ka zbatuar rekomandimet e Panelit vetëm pjesërisht;

VENDOS ta mbyllë shqyrtimin e lëndës

Marina MANCINI,
Ushtruese e detyrës së kryesueses së Panelit



Petko PETKOV,
Anëtar